



Prishtinë, 28 janar 2019

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Është mbajtur mbledhja e parë e Bordit të ZRRE për këtë vit

Sot me 28 janar 2018, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur mbledhjen e tij të parë për këtë vit, ku ka shqyrtuar mbi 20 pika që kanë të bëjnë me rregullimin e sektorit të energjisë në vend.

Bordit në këtë mbledhje ka aprovuar fillimisht Planin trevjeçar të punës (2019-2021) të ZRRE. Plani i punës është një dokument që paraqet hapat e nevojshëm që do të ndërmerren nga ZRRE për përmbushjen e obligimeve që dalin nga legjislacionin primar dhe sekondar. Po ashtu plani paraqet mekanizmat e nevojshëm që do të ndërmerren nga ZRRE për të përmbushur detyrimet në lidhje me hapjen e tregjeve me pakicë dhe rregullimin e sektorit në përgjithësi.

Në këtë mbledhje, Bordi ka amandamentuar Kodin e standardeve elektrike. Kodi i Standardeve Elektrike është dokument që specifikon ndër të tjera standardet e tensionit dhe frekuencës me të cilat operon sistemi energjetik i Kosovës. Ky kod përcakton rregullat që duhet të ndiqen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe nga gjithë shfrytëzuesit e sistemit për të siguruar që prodhimi (gjenerimi), transmetimi dhe konsumi i energjisë elektrike mund të kryhen duke përdorur rrjetin e përbashkët publik të energjisë elektrike.

Bordi ka aprovuar në këtë mbledhje kërkesat për 8 projekte, që do të jenë në pritje, për instalimin e paneleve solare në kapacitet prej 24 MW dhe gjithashtu ka aprovuar kërkesat e dy konsumatorëve për prodhimin e energjisë elektrike për vet-konsum nga panelet solare në kapacitet prej 14.88 kW.

Në mbledhje po ashtu janë shqyrtuar disa ankesa të konsumatorëve si dhe çështje të tjera që ndërlidhen me rregullimin e sektorit dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

